


## Oshënare dëshmore Theodhosia



E premte, 29 maj 2026 – Shenjtori i ditës.

**DITË KRESHME**

Mbyllja e Ngjitjes. Aleksandri i Aleksandrisë. Oshënare dëshmore Theodhosia. Hierodëshmor Olviani i Aneon.

**- OSHËNARE DËSHMORE THEODHOSIA -**

Ishte fëmijë të pasurish të krishterë në Konstandinopojë. Pas zhdukjes së babait të saj, vajza 7-vjeçare ndoqi pas nënën, e cila u tërhoq në një manastir të kryeqytetit. Atje u rrit me dashurinë dhe mëshirën e Perëndisë. Pas vdekjes së nënës, shpërndau pasurinë të të varfrit, duke ruajtur tri ikona ari: të Krishtit, të Nënës së Zotit dhe të shën Anastasisë dhe më pas u bë murgeshë.

Dy vjet më vonë, perandori Leoni III filloi persekutimin kundër ikonave dhe shkarkoi patriarkun, shën Gjermanin, i cili refuzoi t'u nënshtrohej dekreteve të tij. Urdhëroi të hiqte ikonën e Krishtit që gjendej mbi portën e Bronzit. Theodhosia, e cila ishte e pranishme me shumë të tjerë, u shty nga një indinjatë dhe e hodhi tutje shkallën, në të cilën po ngjitej agjenti i perandorit. Grupi i besimtarëve u drejtua më pas drejt patriarkanës për të qëlluar me gurë patriarkun e ri Anastas. Me urdhër të perandorit, ushtarët i kapën që t'i ekzekutonin (martirët e parë të ikonoklazmës nderohen më 9 gusht). Një prej tyre e zvarriti brutalisht Theodhosinë në tokë deri

në vendin e quajtur “Demi” dhe i ngulën një bri dashi në grykë.

\* \* \* \* \*

- HIERODËSHMOR OLVIANI I AENON -

Gjatë persekutimit të Dioklecianit, qeveritari i provincës së Azisë, Julius Sextus Elianus, ngarkoi priftërinjtë paganë, Agripini dhe Klementi, që t'i bindnin të krishterët e Aenon, qytet në jug të Efesit, të hanin nga sakrificat ofruar idhujve në tempullin e Herës dhe të Diellit.

Ata arrestuan episkopin e qytetit, Olvianin, për ta detyruar t'i nënshtrohej këtij dekreti të ndyrë, duke tërhequr kështu edhe të krishterët e tjerë në mohimin e besimit. Kur e pyetën për identitetin, Olviani deklaroi se ishte episkop dhe barí i të krishterëve të atij qyteti dhe, se i tillë, do të mbetej deri në vdekje. Pastaj rrëfeu se Ai që ata e përçmonin si të Kryqëzuar, është ndihmësi dhe mbrojtësi i të gjithë atyre që e besonin si Birin e Perëndisë së gjallë, i Cili vdiq për shpëtimin tonë dhe për këtë arsye mbanin me krenari emrin të krishterë.

Me këmbëngulje të palëkundur nuk pranoi të sakrifikonte, ndaj dhe priftërinjtë paganë e vunë në tortura. Xhelatët ia shpuan kurrizin dhe të përbrendshmet me hekur të hollë të skuqur, por nuk lëshoi asnjë britmë dhimbjeje, vetëm psherëtinte dhe, duke parë nga qielli, thoshte: “Armiq të Perëndisë, mund të më bëni çfarë të doni, por mishi im nuk ndien asgjë, ndërsa shpirti im është i paprekur”. Një nga torturuesit thirri: “Lëri fjalët e mëdha! Mos të duket vetja më i mirë se ne që iu nënshtroam urdhrave të perandorit?”. Shenjtori iu përgjigj: “Po, ndryshojmë shumë, pasi ju e adhuroni me dëshirë djallin dhe kotësinë e tij, ndërsa unë adhuroj Jisu Krishtin, i Cili do të vijë në botë të gjykojë të gjallët e të vdekurit dhe dëshira ime e vetme është të ngulmoj në predikimin e emrit të Tij”.

Nga frika se mos me shembullin e tij kthente të tjerë në besim, priftërinjtë i thanë qeveritarit se Olviani kishte fyer perandorin dhe perënditë dhe se e nxiste popullin të ngrinte krye. Eliani dërgoi ushtarë për ta detyruar, por më kot. Atëherë e zhveshën dhe e kamxhikuan mizorisht; pastaj ndezën një zjarr të madh jashtë qytetit dhe shenjtori hyri vetë në të, për habi të të pranishmëve, duke rrëfyer Krishtin, i Cili e kishte çliruar nga dora e të pabesëve. Të krishterët e qytetit mblodhën eshtrat e tij dhe i vendosën si gurë të çmuar në një vend aty afër, ku shkonin çdo vit për të kremtuar kujtimin e tij. Bashkë me shën Olvianin u martirizuan edhe nxënësit e tij: Makedoni, Simfori dhe Kalisti.

[Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë](#)